



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5, 15.1(c) dhe 21.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil

Duke pasur parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tej referuar si "Marrëveshja për HPEA") në emër të Kosovës, nga ana e UNMIK-ut, si dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes për HPEA, për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka pranuar obligimet ndërkombëtare të Kosovës përfshirë edhe ato të lidhura në emër të Kosovës nga UNMIK-u,

Duke pasur parasysh obligimin nga Marrëveshja për HPEA, që kërkesat e përbashkëta të aviacionit (JAR) të miratuara nga Autoritetet e Përbashkëta të Aviacionit, të jenë pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 4/2010
MBI KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR PËRVETËSIMIN, LËSHIMIN,
RINOVIMIN DHE RIZGJATJEN E LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE PËR
STAFIN E AVIACIONIT - PILOTËT E HELIKOPTRËVE

Neni 1
Zbatueshmëria

Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe procedurat për përvetësimin, lëshimin, rinovimin dhe rizgjatjen e licencave dhe autorizimeve për pilotët e helikopterëve, si dhe programet për trajnim, testim dhe krijimin e aftësive profesionale dhe kushteve që duhet të përmbushen nga personat juridik të cilët kryejnë trajnimin për pilot të helikopterëve.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Rregulloreje përdoren përkufizimet në vazhdim:

Autoriteti - nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AACK),

Organizatë Trajnuese e Fluturimit (FTO) - person juridik i autorizuar për të mbajtur trajnime profesionale për marrjen e licencave dhe autorizimeve për pilot,

Shtet anëtar në JAA - nënshkrues i Marrëveshjes për zhvillimin, pranimin dhe zbatimin e Kërkesave të Përbashkët të Aviacionit (JAR), nënshkruar në Qipro më 11 shtator 1990,

Autoritetet e Përbashkëta të Aviacionit (JAA) - agjencion i asociuar me Konferencën Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC), e përbërë nga përfaqësues të agjencioneve përgjegjëse për lëshimin e rregullave në fushën e aviacionit civil për shtetet anëtare,

Kërkesat e Përbashkëta të Aviacionit - Licencimi i ekuipazhit të Fluturimit (JAR FCL) - rregullore të aviacionit për kushtet dhe procedurat për marrjen e licencave dhe autorizimeve për anëtarët e ekuipazhit të fluturimit,

Licencë piloti - helikopter - dokument i cili i mundëson mbajtësit të saj për të kryer detyrat e anëtarit të ekuipazhit të fluturimit në helikopter, në përputhje me autorizimet e shkruara në licencë dhe në varësi të llojit të licencës,

Organizatë Trajnuese për Kualifikim dhe Llojin (TRTO) - person juridik i autorizuar për të mbajtur trajnim profesional për përvetësimin e llojit,

Neni 3

Licencat dhe Autorizimet

3.1 Licencat dhe autorizimet për pilotët e helikopterëve merren, zgjaten ose rinovohen në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

3.2 Kushtet dhe procedurat për marrjen, dhënien, rinovimin ose zgjatjen e licencave dhe autorizimeve për pilot të helikopterëve janë dhënë në Pjesën 1 (Kërkesat) të JAR FCL 2 dhe Pjesën 2 JAR FCL 2 - Materiali Udhëzues i Pranueshëm (AMC) dhe Materiali Interpretues dhe Shpjegues (IEM).

3.3 Pjesa 1 (Kërkesat) e JAR FCL 2, siç janë referuar në paragrafin 3.2 të këtij neni është e ndarë në nënpjesë nga A deri në J:

1. Nënpjesa A - Kërkesat e përgjithshme;
2. Nënpjesa B - Pilot Student (Helikopter);
3. Nënpjesa C - Licenca për Pilot Privat (Helikopter) - PPL (H);
4. Nënpjesa D - Licenca për Pilot Komercial (Helikopter) - CPL (H);

5. Nënpjesa E - Kualifikim për Instrument (Helikopter) - IR (H);
6. Nënpjesa F - Klasa dhe Lloji i Kualifikimit (Helikopter);
7. Nënpjesa G - Licencë për Pilot të Transportit Ajror (Helikopter) - ATPL (H);
8. Nënpjesa H - Kualifikimi për Instruktor (Helikopter);
9. Nënpjesa I - Ekzaminerët (Helikopter);
10. Nënpjesa J - Kërkesat për njohuri teorike dhe procedurat për kryerjen e ekzaminimeve teorike për licenca profesionale për pilot dhe kualifikimet për instrumente;

Neni 4

Programet Trajnuese Profesionale

4.1 Trajnimi profesional për anëtarët e ekuipazhit të fluturimit - pilotët e helikopterëve mund të bëhet nga FTO dhe TRTO të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe autorizohen nga AACK-ja, si më poshtë:

4.1.1 FTO duhet të përmbushin kushtet e Pjesës 1 Nënpjesa A - Shtojca 1a e JAR-FCL 2.055.

4.1.2 TRTO duhet të përmbushin kushtet e Pjesës 1 Nënpjesa A - Shtojca 2 e JAR-FCL 2.055.

4.1.3 Objektet për PPL Vetëm për Instruksione duhet të plotësojnë kushtet e Pjesës 1 Nënpjesa C - Shtojca 1 dhe 2 e JAR-FCL 2.125.

Neni 5

Programet për Trajnime Profesionale

5.1 Trajnimi profesional për marrjen e licencave, autorizimeve dhe autorizimeve të veçanta duhet të bëhet në përputhje me programet e autorizuara nga AACK-ja.

5.2 FTO, TRTO dhe Objektet për PPL Vetëm për Instruksione duhet të zhvillojnë programe në përputhje me paragrafin 5.1 të këtij neni dhe programet e Pjesës 2 të JAR-FCL 2 Materiali Udhëzues i Pranueshëm (AMC) dhe Materiali Interpretues dhe Shpjegues (IEM).

Neni 6

Materiali Administrativ dhe Udhëzues

Versioni i fundit i JAA AGM (Materialit Udhëzues Administrativ - Seksionit 5 dhe 6) është pranuar si praktikë e rekomanduar për detyrat administrative dhe procedurat e kryera nga Autoriteti.

Neni 7
Interpretimi

Në rast të ndryshimit të varianteve të përkthyer të JAR-FCL 2 në gjuhët shqipe dhe/apo serbe me variantin origjinal në gjuhën angleze, varianti në gjuhën angleze i JAR-FCL 2 (Amendamenti 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6), i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje, do të ketë përparësi.

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 10 tetor 2010.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm